



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.179/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR dhe subjektit politik FJALA, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,400.00 (njëmijë e katërqind) euro, si dhe subjektit politik FJALA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,400.00 (njëmijë e katërqind) euro.

**II.** Koalicioni LDK-AKR dhe subjekti politik FJALA, detyrohen ti paguajnë gjordat e shqiptuara si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 09.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 09.06.2017, në Rrugën “Bajram Kelmendi”, në Prishtinë, monitoruesi i tyre ka hasur në postere të kandidatëve për deputet nga koalicioni LDK-AKR si dhe të subjekti politik FJALA, të ngjitura në objekt publik, gjegjësisht transformator të enërgjisë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b), i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se e kemi urdhëruar kandidatin për të ndërmarr veprime përmirësuese, dhe se posteri dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një foto nga vendi ku janë larguar posterat.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e deputetëve nga radhët e Koalicionit LKD-AKR dhe subjekti politik FJALA, janë vendosur në objekt publik, gjegjësisht në transformatorin e energjisë elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicionii LDK-AKR, dhe subjekti politik FJALA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga ky koalicion dhe materialet njoftuese për fushatën zgjedhore janë vendosur në objekt publik. Poashtu si rrethanë, Paneli mori edhe faktin se Koalicionit LDK-AKR dhe subjektit politik FJALA, ja dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmisimin e shkeljeve ashtu që kanë tërhequr posterat dhe materialet për fushatën zgjedhore nga vendi i palejuar ku kanë qenë të vendosura ato, të cilat veprime kan ndikuar në lartësin e gjobave të shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.179/2017 më datën 10.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.